

RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA
VITI 2015



RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR PËR QËLLIME TË VEÇANTA
PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA
NGA PARTIA
"Fryma e Re Demokratike"

Tirane më, 10 Nentor 2016

Tabela e përmbajtjes

RAPORTI I VEÇANTË I AUDITIT TË PAVARUR
PASQYRA E TË ARDHURAVE (Financimet dhe Donacionet)
PASQYRA E SHPENZIMEVE (Përdorimi i fondeve sipas destinacionit)
INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Referencat ligjore:

Për kryerjen e këtij misioni jemi mbështetur në përputhje me:

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit me referencë të veçantë SNA 800.
- Ligjin nr.10019.datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"
- Ligjin nr.10091.datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar"
- Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë "Fryma e Re Demokratike".

RAPORT I AUDITUSES MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PËR QËLLIME TË VEÇANTA.

MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA DHE SHPENZUARA TË PARTISË "FRYMA E RE DEMOKRATIKE"

Adresuar : KOMISIONIT QËNDROR ZGJEDHOR
PARTISE FRYMA E RE DEMOKRATIKE

Të nderuar zotërinj

Unë, Vullnetare Hoxha (Çela) në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Autorizuar (Auditore e pavarur) jam caktuar me Vendimin nr.126, dates 20.09.2016 të Komisionit Qendror te Zgjedhjeve si dhe Kontratës së Shërbimit nr.3392 të dates 12.10.2016, për kryerjen e auditimit te fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjate vitit kalendarik 2015 të Partisë "Fryma e Re Demokratike".

Ne kemi audituar pasqyrat bashkelidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjate vitit kalendarik 2015. Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të Partisë "Fryma e Re Demokratike".

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin tonë.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit, me referencë të veçantë SNA 800 (raporti i auditorit për angazhime auditimi me qëllime të veçanta).

Këto standarte kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të zotëruar siguri te arsyeshme se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare të arkëtimit-pagesave.

Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës së arkëtimit-pagesave.

Ne çmojmë se auditimi ynë përbën një bazë të arsyeshme për të shprehur opinionin tonë. Politika kontabël e ndjekur nga ana e subjektit zgjedhor Partia "Fryma e Re Demokratike" është të përgatisë pasqyrat bashkelidhur mbi bazën e arkëtimit dhe pagesave. Mbi këtë bazë, e ardhura është njohur në momentin e arkëtimit dhe shpenzimet në momentin e pagesave.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave, mbi bazën e testeve, të fakteve dhe dokumentatve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Ai përfshin

gjithashtu, vleresimin e parimeve kontabel te ndjekura, vleresimet e rendesishme te bera nga Drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyres se fondeve te arketuara dhe shpenzuara per vitin 2015.

- a. Lidhur me shpenzimet u krye verifikimi dhe kontrolli i plote per te gjithë elementet e mesiperm dhe u siguroam se klasifikimi i tyre dhe paraqitja ne pasqyren financiare eshte i sakte, duke dhene nje imazh te qarte mbi destinacionin e perdorimit te tyre. Ne shpenzimet jane perfshire te gjitha dokumentat justifikuese qe na u vune ne dispozicion pavaresisht se nje pjese e faturave te shpenzimeve te tyre nuk jane fatura te rregullta te njohura nga organet tatimore.

Sipas opinionit tone, me perjashtim te pikës (a), pasqyrat financiare e fondeve të përftuara dhe shpenzuara nga Partia Fryma e Re Demokratike për vitin 2015 japin siguri të arsyeshme dhe një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të pasqyrave financiare.

**Eksperte Kontabël e Regjistruar
Vullnetare Hoxha (Çela)**

Tiranë më, 05 Nentor 2016

Adresa Rr. "Komuna e Parisit" Kulla nr. 4, Tiranë.
Cel.0682087442,
Tel zyre 2445486
E-mail:vullnetarecela@hotmail.com

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor Partia "Fryma e Re Demokratike" e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar, me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Subjekti është i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me Nipt L31525455C.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë politike" neni 9, 10, 11 e të tjerë.

Qëllimi dhe objektivat e kësaj Partie gjejnë pasqyrim të qartë në Programin dhe Statutin e saj.

Subjekti zgjedhor Partia "Fryma e Re Demokratike" është një bashkim politik i qytetarëve shqiptarë e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Qendra e Partisë "Fryma e Re Demokratike" është në Tiranë.

Selia e Partisë "Fryma e Re Demokratike" është në rrugën "George W. Bush", Tiranë.

Objekti i veprimtarisë :

Qëllimi i Partisë "Fryma e Re Demokratike" është të forcojë eksperiencën politike demokratike në Shqipëri duke promovuar vlera demokratike.

Burimet e financimit janë :

- | | |
|--|----------------|
| - Buxheti i Shtetit financiar gjate vitit kalendarik 2015 | 3,573,000 lekë |
| - Donacione nga anetaret e FRD jane | 2,235,522 lekë |
| - Burime të tjera të ligjshme sipas legjislacionit shqiptar. | Zero.(0) |

Burimet financiare jane përdorur drejtpërsëdrejti për të realizuar qëllimet dhe objektivat e subjektit zgjedhor.

Organet e Partisë Fryma e Re Demokratike në nivel qendror janë:

Asambleja Kombëtare;

Këshilli Kombëtar;

Bordi Drejtues;

Kryetari i Partisë;

Kryetari i Partise eshte Z.Bamir Topi

Partia ka vulën, logon, flamurin dhe stemat e saj.

1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL

a. Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar, të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhën vendase në Lekë .

Burimet e financimit të Partise janë:

- Te ardhurat nga buxheti i shtetit në përputhje me ligjislacionin për financimin e partive politike;
- Ndihmat dhe dhuratat e anetaresise dhe të përkrahësve të FRD;
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me ligjislacionin për financimin e partive politike.

Selia e Partise është në Tiranë, në adresën Rr."George W. Bush" , Tiranë

b.Politikat operuese

Drejtimi i Partise ka operuar për periudhën që auditohet në pajtim me ligjin 10019, datë 29.12.2009 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ligjin 8580 datë 17/02/2000 "Për partitë politike" i ndryshuar, dhe ligjin Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i datës 29.04.2004, dhe në konformitet me aktet nënligjore, me objektin e veprimtarisë për të cilin është krijuar dhe programi të caktuar nga organet qendrore.

c.Rregullat e vlerësimit

-Mënyra e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Bazuar në auditimin e kryer, rezultoi se të ardhurat janë evidentuar dhe deklaruar në bazë të arkitimeve faktike, kontabiliteti është ndërtuar mbi bazën e parimeve të konstatimit, duke zbatuar parimin e kujdesit, ndërkohe që shpenzimet janë evidentuar dhe deklaruar në momentin e kryerjes së tyre.

-Monedha e raportuar

Drejtimi financiar i Partise ka perdorur si monedhe baze raportimi monedhen kombetare Leke. Fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera jane mbartur ne dokumentacionin fillestar ne monedhat ALL. Pasqyrat jane pergatitur ne Leke.

-Taksat dhe Kontributet .

Partia eshte e perjashtuar nga tatimi mbi fitimin. Partia i ka shlyer detyrimet qe lindin per Sigurimet Shoqerore dhe Shendetesore te punonjesve dhe per Tatimin mbi te ardhurat personale.

2.FONDET E PERFITUARA NGA PARTIA FRD PER VITIN 2015

Per vitin 2015, Partia Fryma e Re Demokratike ka perfituar fonde nga :

- Buxheti i shtetit 3,573,000 lekë
- Kontribut nga anetaret 2,235,522 lekë

Partia operon me Banken BKT me numer llogarie nr. 426668071.

3.SHPENZIMET

PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA DHE SHPENZUARA

PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA DHE SHPENZUARA VITI 2015
PARTIA FRYMA E RE DEMOKRATIKE

Gjendja	75,471
Subvencion nga buxheti i shtetit	3,573,000
Kontribut nga anetaret	2,235,522
TOTALI I TE ARDHURAVE	5,883,993

Pershkrimi i shpenzimeve	Periudha	Nr.fature	Vlera
Shpenzime per qera			2,292,500.00
Shpenzime per energji elektrike			66,486.00
Shpenzime telefonie dhe interneti			92,757.00
Shpenzime kancelarie			107,055.00
Shpenzime zyre			35,054.00
Komision bankar			2,044.05
Shpenzime auditimi			118,800.00
Shpenzime copier			174,800.00

Totali **2,889,496.05**

Shpenzime web-sitin e FRD-se,taksat e bashkise,shpenzime mirembajtje	95,140.00
Totali	95,140.00

Shpenzim per fushaten e zgjedhjeve Vendore te 23.06.2015	1,882,510.00
Shpenzime per kurora dhe flamuj	60,120.00
Shpenzim per gazeten "Fryma e Re"	799,500.00
Totali	2,742,130.0

Totali gjithesej **5,726,766.05**

Gjendja ne fund **157,227.34**

Lidhur me shpenzimet e mesiperme, u krye verifikimi dhe kontrolli i plote per te gjithe elementet e mesiperme dhe u siguruar se klasifikimi i tyre dhe paraqitja ne pasqyren financiare eshte i sakte, duke dhene nje imazh te qarte mbi destinacionin e perdorimit te tyre.

Shpenzimet jane me dokumenta justifikues qe na u vune ne dispozicion, pavaresisht se nje pjese e faturave te shpenzimeve nuk jane me fatura te rregullta te njohura nga organet tatimore.

Nga shpenzimet e kryera dhe te pasqyruara ne pasqyren e fondeve te perfituar dhe shpenzuar po japim disa shpjegime te shkurtra per secilin ze si me poshte :

5.1 Shpenzime telefonie, interneti, etj

Gjate vitit 2015 shpenzimet per telefoni,internet,etj jane ne shumen 92,757 leke. Pagesa eshte bere me leke ne dore, kundrejt fatures se rregullt tatimore.

5.2 Shpenzime kancelarie

Shpenzime kancelarie per blerje te ndryshme jane ne vleren 107,055 leke. Pagesa eshte bere me leke ne dore kundrejt kuponave tatimore .

5.3 Shpenzime energjie

Vlera e ketij shpenzimi eshte 66,486 leke.Pagesa eshte kryer me arke kundrejt faturave ligjore te leshuara nga OSHEE.

5.4 Shpenzime per gazeten FRD

Vlera e ketij shpenzimi eshte 799,500 leke.Pagesa eshte kryer me arke kundrejt dokumentave justifikues.

5.5 Shpenzime website,takse vendore, etj

Vlera e ketyre shpenzimeve eshte 95,140 leke.Pagesa eshte kryer me arke kundrejt mandat arketimit te leshuar nga Bashkia Tirane dhe faturave jo tatimore.

5.6 Shpenzime te tjera

Ne shpenzime te tjera perfshihen:

- Shpenzimet e fushates se zgjedhjeve vendore te qershorit te vitit 2015 ne vleren 1,882,810 leke.Nje pjese e dokumentave justifikues per keto shpenzime jane fatura te parregullta tatimore dhe nuk permbajne Niptin e shitesit.
- Shpenzime zyre dhe mirembajtje ne shumen 269,974 leke.Pagesa eshte kryer me leke nga arka dhe nje pjese e dokumentave justifikues jane fatura jo te rregullta tatimore.
- Shpenzimet e qerases ne shumen 2,292,500 leke ku perfshihet qeraja e selise se FRD-se si dhe qerates e sallave ku jane zhvilluar aktivitetet e ndryshme nga FRD. Pagesa e ketyre shpenzimeve eshte kryer me mandat pagese ne baze te kontratave te qerases.
- Shpenzime auditimi ne shumen 118,800 leke.Pagesa eshte kryer nepermjet llogarise bankare ne baze te kontrates se lidhur me audituesin.

Persa i perket menyres se pasqyrimet te te dhenave per perfitimet dhe shpenzimet e fondeve per periudhen 2015 theksoj se partia FRD, deri ne muajin shtator 2015, ka kryer pagesa bazuar ne fatura jo te rregullta tatimore dhe pas muajit shtator pagesat jane kryer bazuar ne fatura te rregullta tatimore.

Gjate vitit 2015 likujdimi i pjeses me te madhe te shpenzimeve eshte kryer nepermjet arkes dhe nje pjese e vogel e shpenzimeve jane likujduar nepermjet bankes.Per kete

arsye rekomandojme që në të ardhmen veprimet per likuidimin e shpenzimeve dhe furnitoreve të kryhen nëpërmjet llogarisë bankare.

6.LIKUJDITETET

Gjendja e likujditeve me datë 31.12.2015 në llogarinë bankare është 157,227 lekë.

Gjendja e likujditeve në fund të periudhës

Pershkrimi	Monedha	Kursi	Vlera lek	Vlera euro	Totali ne leke
Arka	Leke	1	0	0	0
Banka			157,227		157,227
Totali			157,227	0	157,227

7.NGJARJE TE MEVONSHME

Nuk ka patur ngjarje te mevonshme qe mund te influencojne ne pasqyrat financiare te mesiperme.

Eksperte Kontabel e Rregjistruar

Vullnetare Çela (Hoxha)

Tiranë më, 10 Nentor 2016

